Vdekje fashizmit — Liri Popullit

Poštarina plaćena u gotovu
Taksa postale e pagueme

RILINDJA

ORGAN I FRONTIT POPULLUER TE KOSOVES E METOHIS

...ЛАЗИ ДВА ПУТА НЕДЕЉНО:
...ТВРТКОМ И НЕДЕЉОМ

DEL DY HERE NE JAVE:
T'EJTEN DHE TE DIELLEN

Redaksija Prishtine
Rruga Emin Duraku Nr. 1

PAJTIMET
per 1 vit 192 din
— 6 muej 96 —
— 3 muej 48 —

Dorshkrimet nuk kthehen

Odgovorni urednik XHELADIN
Drejtori pergjegjes HANA

Vjeti IV Nr. 141 | PRISHTINE, e ejte 2 Shtatur 1948 | Çmimi 2 dinarë

KONKLUZAT E PLENUMIT TE FRONTIT POPULLUER KRAHINUER NE LIDHJE ME KONGRESIN E V-të PKJ

Te djelen me date 29 gusht te k. v. u-mbajt mbledhja plenare e Keshillit Krahinuer te Frontit Populluer. Me kete rast shoku Gjoko Pajkoviq, sekretar i Keshillit Krahinuer te Frontit Populluer mbajti nji referat ne lidhje me vendimet e Kongresit te Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis dhe mbi detyrat e antarve te Frontit. Mbas referatit u-zhvillue nji diskusjon i gjane. Ne mbarim mbledhja prumi keto

KONKLUZA

Kongresi i Peste i Partis Komuniste te Jugosllavis ka rendesi shum te madhe historike per te gjithe popujt t'one, sepse tregon rrugen kah forcimi dhe perforcimi i matutjeshem i kompaktesis t'one shtetnuer, i lidhjes se puntorve dhe katundarve dhe ndertimit te socjalizmit ne vendin t'one — gja qe jane njikohesisht edhe detyrat kryesore te Frontit populluer. Tue u nise nga kjo, para organizatave te Frontit populluer ne Krahinen e Kosoves dhe Metohis parashtrohen keto detyra:

1. Me organizue punen e gjane agitatore propagandistike per shkak te njohjes se turmave ma te gjana popullore me vendimet e Kongresit te V-te te Partis Komuniste te Jugosllavis. Per kete qellim duhet me organizue pranë te gjitha keshillave te Frontit, seminare dhe qerthuj per punen ideo-politike, e ne seminare te veçanta, me pregatite kuadra te cilat do te mbajne ndermjet tjerash ligjerata mbi luften nacionalçlirimtare dhe mbi ceshtjet aktuale te ndertimit te socjalizmit n'atdheun t'one, ne baze te marksizem-lenjinizmit, dhe ne te gjitha aksjonet masovike ne lidhje me vendimet e Kongresit.

2. Nepermjet te zgjidhjes se detyrave, qe i parashtron Plani pesvjeçar, tue u kapercye te tij, me pa u ... per ... dhe perforcimin e bashkimit te turmave popullore te bashkuem ne Frontin populluer ne vijen e luftes per ... e mbeturinave kapitaliste ne qytet dhe shtypjen e matutjeshme t'elementave kapitalista ne katund. Me kete rast me luftue edhe ma tutje kunder te gjitha shmangejeve e sidomos shmangejeve nacionaliste dhe per thellimin e vllaznimit dhe te bashkimit te popujve te Kosoves e Metohis dhe te mbare Jugosllavis. Me demaskue politiken e imperjalistave, te cilet perpiqen per robnimin politik dhe ekonomik te popujve dhe per shkaktimin e grindjeve te reja luftarake.

3. Me punue per aktivizimin dhe pjesmarrjen e turmave ne ndertimin e pushtetit t'one populluer dhe per zbatimin e politikes se tij me anen e sqarimeve politike per kryemjen e masave konkrete te pushtetit populluer, drejtue kah realizimi i detyreve te parashtruara nga Plani pesvjeçar, sikurse jane: grumbullimi i drithit kontraktuel i misrit, lavrimi i thelle i tokes ne dimen, mbjellja, caktimi i tatimit dhe per mbajtjen e mbledhjeve te zgjedhesve, ku do te kryhet kontrollimi masovik i punes se keshillave popullore, ku do te gjykohet puna e tyne, do t'u ipen propozime

do te forcohet lufta kunder byrokratizmit, do te ndrrohen keshilltaret e dobet, dhe ku do te zgjidhen njerzit ma te mire.

4. Me punue ne menyre qe te ndihmohet pushteti populluer ne mobilizimin e fuqis punjore per sipermarrjet t'ona, tue i bindë elementat ma te varfer te katundit per dobin e hymjes se tyne n'ekonomi dhe tue iu dhane ndihme familjeve te tyne per punimin e tokes, per punet investicjonale, dhe per ndertimin e shtepijave kooperative. Me e perforcue sidomos punen per forcimin dhe perforcimin organizativ te brigadave punuese te Frontit, qe punojne ne punet investicjonale te shtetnuer dhe ne ndertimin e shtepijave kooperative.

5. Me i aktivizue te gjitha organizatat e Frontit per forcimin dhe zhvillimin e kooperativave bujqesore tue u-perpjeke qe te gjithe frontistat te regjistrohen ne kooperativat bujqesore, tue e ndihmue formimin e keshillave per perparimin e organeve te bujqesis dhe per punimin kolektiv te tokes, tue aktivizue kooperativistat per pjesmarrjen ne kooperativa dhe drejtimin e tyne.

Me u spjegue turmave katundare dobin dhe nevojen e perparimit te bujqesis me anen e zbatimit te masave agroteknike, me anen e perdorimit te mashinerive moderne bujqesore dhe me marre masa praktike ne kete drejtim.

6. Ke disa puntore t'one me i perforcue edhe ma teper gurat, me ba lufte per diciplinen ma te mire ne pune, per paksimin e shpenzimeve te prodhimit, per qendrimin e drejte ndaj punes, per pergjithsimin dhe zbatimin e metodave te reja te punes dhe per rritjen e pasunis se popullit, per ngritjen e matutjeshme ideo-politike te puntorve t'one, tue pase kujdes ma te madh per plotsimin e nevojave te tyne ne te furnizuemit vendosje dhe kujdesimin per puntoret e ardhun rishtas.

7. Me ba lufte per ngritjen kulturale te popullit tue i dhane ndihmen sa ma te madhe organeve arsimore per zhdukjen e analfabetizmit ne Krahinen t'one, per zhvillimin e punes kulturo-arsimore ne format ma te gjana popullore dhe per vazhdimin e shkollave.

Telegrami i derguem shokut Tito nga Plenumi i Frontit Populluer Krahinuer

Shok i jone i dashtun Tito,

Prej kesaj mbledhje plenare ku jemi bashkue per t'i permbledhe rezultatet e punes s'organizatave te Frontit ne periudhen e deritashme, si edhe per shiruemjen e detyrve te reja dhe marrjen persiper te detyrimeve te reja ne baze te vendimeve te Kongresit te Peste historik te PKJ-s, Te dergojme, shok Tito, pershendetjet t'ona te zjarrta frontiste dhe urojme qe t'u prijsh popujve t'one me vjete e vjete prej fitorje ne fitore, ashtu siç na ke pri edhe deri tash ne ndertimin e socjalizmit n'atdheun t'one-RFPJ.

Nen udheheqjen T'ande t'urte, populli i Kosoves e i Metohis-shqiptare, serbe e malazeze-per heren e pare kane sigurue lirin e tash, te barabarie ne te drejta me popujt e tjere te komunitetit vllaznuer te popujve te Jugosllavis, ndertojne socjalizmin n'atdheun e vet, tue i kapercye te gjitha pengesat dhe veshtiresinat. Jemi te bindun dhe besojme ngultazi se kemi me i mposhte te gjitha veshtiresinat ne permbushjen e Planit te pare pesvjeçar edhe ne ndertimin e matutjeshem te socjalizmit vetem nen udheheqjen t'ande e nen udheheqjen e KQ te PKJ, ne krye te te cilit je Ti.

Sukseset dhe rezultatet qe kane mbrrijte organizatat t'ona te Frontit ne lufte per plotsimin e Planit per periudhen e deritashme na tregojne se njerezit punuesa te qyteteve dhe katundeve te Krahines s'one, te bashkuem ne Frontin populluer nen udheheqjen e Partis s'one, do te mbrrijne suksese edhe ma te mdhaja. Kete na e garantun edhe Kongresi i Peste i PKJ-s, i cili na ka dhane fuqina te reja dhe na ka armatose me vendimet historike, te cilat jane arme e fuqishme ne duert t'ona ne luften per ndertimin e socjalizmit dhe kapercimin e te gjitha pengesave qe na dalin ne ket rruge.

Neve na rritet zemra kur shofim unitetin dhe kompaktesin e Partis s'one te lavdishme, qe u-çfaq aq fuqishem ne Kongresin e Peste. Jemi te lumtun dhe krenar qe Kongresi i Peste mujti, me fakte te pakontestueshme, me i shparcallue shpifjet qe iu hudhen prej disa partive komuniste Partis s'one, Komitetit te saje Qendruer heroik, atdheut t'one te lavdishem-neve te gjithe. Edhe me kete rast shprehim indinjaten t'one te thelle per keto pohime te perbindshme e te paturpshme e te pa kurrfare baze, te cilat na i hedhim poshte si shpifjet ma te ndytat. Te çfaqim falenderimin t'one Ty, shok Tito, dhe KQ te PKJ-s perqendrimi ne urte dhe te njerzishem ne kete fushate te perbindshme qe zhvillohet kundra Vendit t'one, per ate qe po bani dhe qe keni ba per mprojtjen e nderit te Partis s'one dhe Vendit t'one dhe triamfin e drejtesis per popujt t'one. Jemi te vetdijshem se lufta per ndertimin e socjalizmit ne Vendin t'one kontribon shum ne forcimin e kampit socjalist, me BRSS ne krye.

Te premtojme, shok Tito, se, tue marre si pasqyre unitetin dhe kompaktesin e PKJ-s, do ta ruejme dhe do t'a forcojne unitetin e masave t'ona punuese te bashkueme ne Frontin Populluer, me Partin t'one lavdishme Komuniste te Jugosllavis ne krye, se do t'a shtojme punen e organizatave t'ona te Frontit ne luften per kryemjen e Planit dhe se te gjithe antarve te Frontit te Krahines s'one do t'ua bajme te njoftuna vendimet e Kongresit te Peste historik te PKJ-s.

Rrnofte biri dhe mesuesi ma i madhi i popujve t'one, shoku Tito!

Rrnofte Fronti Populluer i Jugosllavis!

Rrnofte Partija Komuniste e Jugosllavis, ne krye me shokun Tito!

Rezolucjoni i Plenumit te Keshillit Krahinuer te Frontit populluer ne lidhje me Rezolucjonin e Byros Informative

Në mbledhjen e vet plenare Keshilli Krahinuer i Frontit populluer te Krahines Autonome te Kosoves e Metohis ne lidhje me rezolucjonin e Byros Informative, te disa Partinave Komuniste dhe çpifjeve kundra vendit t'one bjen ket.

REZOLUCJON

1. Keshilli Krahinuer i Frontit populluer te KAKM-it e pranon ne tanesi rezolucjonin e Kongresit te Peste te PKJ-s mbi qendrimin ndaj Byros Informative, sepse ai i çfaqe plotsisht mendimet dhe ndjenjat si te Keshillit Krahinuer te Frontit populluer, ashtu edhe te turmave te gjana punuese te Krahines s'one.

Rezolucjoni i Byros Informative e sulmon ne menyre te perbindshme dhe ma te paturpshme jo vetem Komitetin t'one Qendruer dhe shokun Tito, por edhe mbare Partin t'one Komuniste, atdheun t'one te lavdishem, frytet e shkelqyeshme, qe popujt t'one i kane fitue me gjak dhe vuejtje. Prandaj ate rezolucjon dhe fushaten, qe zhvillohet ne baze te saje ne disa vende te demokracis popullore, e denojme si çpifjen ma te paturpshme.

2. Fushata çpifse kunder Vendit t'one ne disa vende te demokracis popullore po merr perpjestime te perbindshme dhe synon me e thye bashkimin e turmave t'ona dhe me e dobesue pamvarsin e Vendit t'one. Prandaj protestojme kunder perpjekjeve te ketilla dhe solidarizohemi me notat, qe u ka dergue RFPJ Qeverinave te republikave popullore te Rumanis dhe te Hungaris. Kerkojme qe Qeverit e permenduna t'a ndalojne ket fushate shkatrimtare, mbassi ajo jo vetem qe e damton Vendin t'one, por i dobeson edhe fuqit e Frontit demokratik, çka don, ne te vertete, me thane-u ndihmon fuqive imperjaliste.

3. I thrrasim te gjitha organizatat e Frontit dhe te gjithe njerezit e punes te Krahines s'one, te bashkuem ne Frontin populluer, qe t'i perforcojne edhe ma teper rradhet e tyne ne lufte per zbatimin e vendimeve te Kongresit te Peste historik dhe per kryemjen e Planit pesvjeçar, t'a ruejme dhe t'a perforcojme edhe ma teper bashkimin e turmave punuese rreth Partis s'one te lavdishme Komuniste te Jugosllavis-e sprovueme ne zjarrin e luftes me arme dhe per nderimin e socjalizmit-rreth Komitetit Qendruer te Partis Komuniste te Jugosllavis dhe shokut Tito.

Sukseset e puntorve ne sipermarrjen „Ramiz Sadiku“ ne Kamenice

Ne rrethin e Kamenices asht punue pa ne plan ndertimi i nji pjese te mire ndertesash shtetnore: si ajo e stacjonit bujqesuer, e gjygjit populluer te rrethit, e spitalit, banesat per familjet e puntorve dhe te nepunsave, ajo e paragjimnazit — prej 11 dhomash si dhe ajo e stacjonit shendetsuer.

Nder te gjitha keto, puntoret muratore kane korre suksese te dukshme dhe e kane kalue normen e punes me 40%. Shquhen per kalimin e normes puntoret e grupit te Rade Stankoviqit: Dushan Gjorgjeviq dhe Zhivko Zhivkoviq.

Perveç sukseseve ka edhe disa te meta, si per shembull mungesa e banesave per puntoret, te cilet detyrohen me ece disa ore rrezhit per te kalue natën, si dhe puna e tepert 10 orshe ne vend te 8 orshit. Prej kesaj rrjedh qe puntoret nuk kane mundesi te zhvillohen ne pikpamje kulturale

Ne Shqipni asht burgose luftetari antifashist dhe puntori publik i njoftun Nuri Huta

Simbas informatave dihet se qe disa jave gjindet i burgosun nen kushte mjaft te veshtira gazetari i njoftun shqiptar dhe puntori publik — Nuri Huta. Organet e pushtetit te Shqipnis e burgosen Nuri Huten, kur e kundershtoi rezolucjonin e Byros Informative dhe ne baze te njoftjes se thelle si te vijes se PKJ ashtu dhe te realitetit ne RFPJ-n e karakterizoi si çpifje per PKJ-n dhe popujt e RFPJ-s.

Burgimi i Nuri Hutes dhe keqperdorimi qe i bahet ne burg, ka shkaktue pezmatim te madh ne rrethat shqiptare, ne mes te cilave Nuri Huta asht njofte si luftar i çelnikosun per pamvarsin e Shqipnis nga imperjalizmi dhe si puntor i palodhshem per thellimin e miqesis ne mes te popullit shqiptar dhe popujve te RFPJ-s.

Nuri Huta bani pjese ne PK te Shqipnis qe ne ditet e para te formimit te saje. Prej fillimit te luftes s'organizueme t'armatosun kunder okupuesit fashist, Nuri Huta ishte pjese ne çeten e pare partizane te Pezes. Ne lufte Nuri Huta u-dallue me terrejtjen e pa-kufishme ndaj okupuesit fashist dhe te gjithe anmiqve te popullit punues te Shqipnis. Me rastin e kryemjes se nji detyre partizane ne Tirane, Huta u-burgos nga ana e policis italjane fashiste. I shtruem nen vuejtje shtazarake, ai me qendresen e tij u-ba shembull per shoket ne burg. Ne muaj te vjetit 1943 iku nga burgu me nji grup komunista udheheqes te Shqipnis dhe perseri muer pjese ne aradhen partizane.

Mbas çlirimit Nuri Huta ka krye detyre me pergjegjesi n'aparatin shtetnuer dhe ate te Partis. Ai ka qene antar i agitpropit te KQ te PK te Shqipnis, shef i Drejtoratit per shtyp ne Ministrin e Punve te Jashtme, antar'i delegacjonit te RP te Shqipnis pran komisjonit te kombeve te bashkueme ne Greqi. Ne mars te vjetit 1948 Huta ka qene shef i delegacjonit te RP te Shqipnis ne konferencen per lirin e shtypit ne Gjeneve.

Ne vjetin 1947, Nuri Huta u-ba sekretar i shoqnis shqiptare-jugosllave per bashkepunimin kultural. Ai ne kete pune punoi ne menyre te palodhshme dhe me sukses per thellesimin dhe perforcimin e miqesis ne mes te popullit te RP te Shqipnis dhe te popujve te RFPJ-s.

Simbas lajmeve te fundit ne shenj protesti kunder keqperdorimit, te cilit i asht nenshtrue ne burg per shkak te qendrimit te patrandun ndaj çpifjeve te PKJ-s dhe te popujve te Jugosllavis, Nuri Huta ban greve urije.

BLEMJA E DRITHNAVE TE BARDHE

Deri me daten 31 gusht plani i pergjitheshem ne Krahinen t'one asht realizue 38 % e norma ditore me 61,1 %

Ne keto ditet e fundit ka fillue te permirsohet me shpejtesi puna rreth blemjes se drithnave te bardhe. Ne disa rrethe, qe ma pare ishin mjaft mbrapa, tash ka fillue te plotsohet norma e bile edhe te tejkalohet si bje fjala ne rrethin e Mitrovices, ky tejkalohet me 9 per qind. Mandej jane permirsue shum rrethi i Gjakoves, Vucifernes, Rahovecit, Podujeves, etj.

Rrethi	realizimi i planit	norma ditore
Mitrovice	39 per qind	109 per qind
Suhareke	44,3 „	92,3 „
Podujeve	60,9 „	83,4 „
Rahovec	45 „	78 „
Gjakove	72 „	88,4 „
Vuciterne	41,6 „	72 „
Gilan	25,9 „	69 „
Prishtine	37,5 „	69 „
Drenice	17,7 „	37,2 „
Istok	26,5 „	42,5 „
Kamenice	27 „	50 „
Ferizaj	34,2 „	58 „
Peje	32,5 „	63,7 „
Liplan	33,1 „	62,8 „
Prizren	33,8 „	62,9 „

Keshillat e vendit Krushevc, Treboviq e Vitomirice i kane dorzue 100 % sasinat e tepricave te detyrueshme

Fushates per blemjen e drithnave ne rrethin e Pejes i asht kushtue kujdesi i duhun nga ana e organeve te grumbullimit. Keshillat e Frontit ne nji pjese te mire kane dhane te gjitha adlimat per realizimin e planit te parapame. Jane perqindjet qe flasin per perkjet e tyne me i binde masat e gjana. Kete e vertetojne rezultatet e tyne. Bje fjala, keshillat e vendit Krushevc, Treboviq e Vitomirice, e kane plotsue 100% planin e blemjes se drithit. Njikohesisht ne saje te punes aktive te pushtetit popullor e t'organizatave masovike jane arrijte rezultate te mira ne Strelle 98%, Vidanje 97%. Nder keshillat ku interesimi per kete akcjon ka qene i kufizuem kemi keto rezultate, ne Gorazhdevc vetem 26%, Rosuliq 32%. Nuk duhet te harrohet se kto dy te fundit jane nga ma te pasunit e ketij rrethi.

Disa prej keshillave te vendit sidomos nuk e kane evidencen dhe nuk i dergojne planet operative ditore ndermarrjes „Zhitopromet". Gadhjes se blemjes se drithnave deri me tash i jane pergjegje ma se miri prodhuesit e varfun e te mesem, kurse te pasunit me forma te ndryshme pengojne ase nuk e kane dorzue deri me tash, ose e zgjasin me qellim tue e dorzue pjese pjese. Plani ne pergjithesi ne ket rreth deri me 28 te ketij mueji asht plotsue me 52%.

Rezultatet ma te mira per blemjen e mishit gjate muejit gusht jane mbrrijt ne rrethin e Pejes dhe t'Istokut, e ma te dobtat ne rrethin e Ferizajt Suharekes e Liplanit

Rrethi	gja te trasha	gja t'imta
Vucitern	44 per qind	129 per qind
Gilan	46,6 „	151 „
Dragash	22 „	16 „
Prishtine	22 „	153 „
Drenice	— „	55 „
Gjakove	62 „	59,4 „
Mitrovice	29,9 „	194 „
Istok	186 „	72 „
Kamenice	26 „	54 „
Podujeve	35 „	72 „
Ferizaj	8,8 „	9 „
Peje	147 „	150 „
Rahovec	11,6 „	10 „
Liplan	43 „	94 „
Suhareke	8,9 „	7,8 „
Prizren	21 „	29 „

Te shpejtesojme punen per kontraktimin e misrit dhe te pregatitemi per blemje

Kontraktimi dhe blemja e misrit asht nji nga detyret ma te randesishme, mbas blemjes se drithnave te bardhe. Tue qene se misri zen vend mjaft me randesi ne fondin t'one te drithit duhet me u-perpjeke me te gjitha fuqit per plotsimin dhe tejkalimin e planit te parapume. Keshtu kontribuohet per sigurimin e bukes dhe per ngritjen e nivelit te jeteses te njerzeve t'one punues.

Kontraktimi i misrit ka fillue me 15 korrik, mirepo, deri tash nuk jane mbrrijte perfundime te dishrueme. Organet t'ona te blemjes, organet e pushtetit popullor dhe organizatat popullore, t'okupueme me blemjen e drithnave te bardhe dhe me pune te tjera, nuk i jane kushtue sa duhet edhe punes per kontraktimin e blemjes se misrit. Kjo shifet nga fakti se norma e deritashme asht realizue vetem me 25-26%. Kjo pra te jep me kuptue se puna rreth kontraktimit dhe pregatitjeve per blemjen e misrit asht lane thuejse mbas dore. Prandaj asht nji nga detyret e para t'organizatave te Partis dhe t'organizatave te tjera popullore qe t'i bejne kesaj pune dhe t'ia spjegojne gjanesisht cdo katundarit t'one punues randesin qe ka blemja e misrit per Vendin t'one, per realizimin e Planit t'one dhe njikohesisht te nenvizohen te mirat dhe perfitimet e fshatit t'one prodhues qe rrjedhin nga sistemi i ri i blemjes e veçanerisht te mirat qe vijne nga kontraktimi. Kjo detyre bahet aq ma e randesishme kur te merret parasyshe se gjate kontraktimit dhe blemjes se drithnave te bardhe ka mbete nji numer bukur i madh katundaresh pa u-njofte hollesisht me sistemin e ri te blemjes ase nuk jane interpretue drejte te gjitha dispozita e Dekretit perkates. Bashke me spjegimet tjera duhet te behet ne dukje edhe fakti qe katundaret tue i dorzue tepricat e veta te drithit, marrin pjese direkte ne realizimin e Planit t'one kjo don te thote se e indirmojne transformimin e bujqesis-qe asht nji nga detyret ma kryesore. Ne kete menyre do te mundet me u-sigurue sukcesi i plote dhe do te pengohen kryekput orvatjet e spekulanteve te ndryshem, nga tradhet e pasanikeve te katundit, per te pengue blemjen me kohe te tepricave te drithit. Per kete arsye puna politike duhet te jete e vazhdueshme dhe e gjithaneshme si per kah forma asht dhe per kah permbajtja. Aktivistat-agjitatoret duhet te perdorin forma te ndryshme per skjarimin e gjithanshem, tue fillue nga konferencat masovike e deri te puna individuale me cdo prodhues. Ka ngja qe shum prodhues te cilet tash vone e kane marre vesht dobin e kontraktimit jane penduet qe nuk kane kontraktue ma shum dhe me kohe. Per kete arsye asht dashte te zgjatet edhe ma afati i lidhjes se kontratave. Me kete rast do te luen rol me randesi edhe vet perbamja e aktivit t'agjitatorve, ku duhet te marrin pjese aktivistat ma te mire.

Edhe pregatitjet organizative dhe teknike jane perkusht i domosdoshem per sukcesin e plote. Per kete arsye organet e blemjes e keshillat popullore, me ndihmen e organizatave popullore, duhet te marrin masa qe krahas me punen politike te kryhen te gjitha pregatitjet e nevojshme. Me njihere duhet te formohen ekipat per lidhjen e kontratave dhe ketyne t'iu caktohen detyret konkrete, mandej te perpunohen planet perkatese dhe te vehet norma ditore, t'organizohen gara katund me katund, vend me vend, rreth me rreth, te bahet evidenca e perpiket per cdo dite dhe te formohen komisjonet e posacme per te cmuemin e prodhimit te misrit, qe asht nji nga detyret me shum randesi, dhe te sigurohet udheheqja e drejte e te gjitha puneve rreth kontraktimit dhe blemjes.

Keto jane detyret kryesore qe mundet dhe duhet te kryhen sa ma pare. Puna ne ket drejtim duhet te zhvillohet krahas me punen rreth blemjes se drithnave te bardhe dhe mos te lejohet qe per shkak te njenes detyre te lehet mbas dore tjetra.

U dha denimi terroristave ustash dhe shpijujve ne Zagreb. Me varrje u denuen 20 xhelat, me pushkatim - 23 dhe me denime te perkoheshme 12 xhelat

Keshilli i Gjyqit te Nalte te Republikes Popullore te Kroacis u dha denimin xhelatve ustasho-kryzhariste-nike dhe terroristave.

Para salles se madhe plot me publik te Panagjyrit, kryetari i keshillit te gjyqit Dr. Zharko Vimpulshek e lexoi denimin, me te cilin denohen me varrje dhe me humbje te te gjitha te drejtave civile keta:

Lubo Millosh, Ante Verban, Nikolla Petrac, Adam Miljeviq, Mato Vasil, Jakob Martinoviq, Bozhidar Karran, Dr. Vladimir Sobolliq, Vjekoslav Bllashkov, Ingj. Miro Rosandiq, Josip Tomlenoviq, Izidor Cenc—Strumecki, Eduard Kershni, Julije Shpaj, Rudolf Strak, Dr. Emill Tot, Branko Krshtro, Barisha Zhilliq, Ivan Shop, Bozhidar Miqiq.

Te denuem me pushkatim dhe me humbjen e te gjitha te drejtave civile:

Ingj. Bozhidar Petraqiq, Ivica Grzheta, Mio Jagurinec, Ingj. Josip Jezofshek, Vladimir Hranilloviq, Stjepan Krizhaniq, Vjekoslav Stipaniqek, Zhelimir Lilko Todor Paniq, Pavle Vuliq, Ivan Vragolloviq, Milan Pribaniq, Dushan Toshiq, Tahir Allagiq, Ivan Shnill, Josip Matijashiq, Ingj. Franje Petek, Martin Mesiq, Gjuro Prelog, Mihajllo Çota, Eduard Pribilloviq, Jakov Medoniq e Leon Zlatar.

Me humbjen e te drejtave civile per jete dhe me pune te detyrueshme jane denue: Vlado Dundoviq dhe Juro Brozoviq;

Te denuem me nga 20 vjete me humbjen e liris, me pune te detyrueshme dhe me humbjen e disa te drejtave civile:

Nikolla Staniq dhe Nikolla Rupqiq.

Te denuem me 18 vjete humbje te liris, me pune te detyrueshme dhe me humbjen e te drejtave civile:

Zvonko Rezniq, Pero Dujmoviq dhe Marko Juriqiq.

Te denuem me humbjen e liris per 15 vjete:

Vlado Pavlloviq, Milko Zilliq, Ivan Peraniq, Stjepan Baniq dhe Ivan Prusac.

Te gjithe te padituemit jane denue edhe me konfiskimin e gjithe pasunis. Dhanjen e denimit publiku e percjolli me thirrje frenetike per gjyqin popullor dhe per shtetin t'one popullor.

Probleme qe duen zgjidhje ne qytetin dhe rrethin e Mitrovices

Ne Mitrovice — qytet e rreth — problemet e ndryshme te cdo sektori ne pergjithesi zgjidhen bukur mire e shpejte, por ka edhe mungesa te meta dhe gabime, qe duhet te likuidohen.

Furnizimi i popullsis se qytetit me perime, peme e bostan asht i dobet. Nder dyqanet e shitjes fort rralle njerio mund te gjeje peme te mjaftueshme, se me bostan jo se jo. Persa i perket furnizimit me tekstil, deri tash ka shkue mjafte mire, vetem duhet te kerkohet qe edhe per Mitrovicen ndamja te bahet e drejte edhe ne pikpamje kualiteti.

Plani i dorzimit te drithnave te bardhe deri tash nuk asht plotsue vetem ne 58%, kurse tash ka fillue te permirsohet, ndersa ai i perimeve dhe i pemve asht gjithnji i dobet. Nji nder shkaqet kryesore te ketyne te metave asht edhe mungesa e kuadrave t'mire e me eksperience ne seksjonin e grumbullimit prane keshillit popullor te rrethit. Ketyne u shtohet edhe vonesa e paraqitjes se eferaterve te perditshme nga magazinat e rrethit per grumbullim.

Deri tash s'asht permirsue ende nji gabim tradicjonal. Me gjithse Keshilli Krahinor e ka urdhnue keshillin e qytetit me i furnizue me buke 180 puntore te rrethit, te cilet punojne ne bllokun e banesave te Zvecanit dhe n'Ujet e thartet prap se prap deri tash atyne u asht dhane drith e jo buke, gja e cila atyne u ka shkaktue humbje kohe.

Persa i perket fillimit te vjetit shkollor dhe vazhdimit te luftimit t'analfabetizmit ne rreth, konstatohen keto te meta: ne mungese te drrasave nuk jane pregadite ende orendit e shkollave te katundeve, nuk jane pastrue ende shkollat — lokalet private, nuk asht gjete ende zgjidhja per sigurimin e kuadrove udheheqese te kurseve analfabetike per femnit shqiptare nder katunde, gja e cila ka me e pengue plotsimin e planit ne pergjithesi.

Per t'i sigurue orendit e shkollave po te cilat s'asht e mundeshme qe te zhvillohen mesimet ashtu si duhet, lypset qe rreth mundesive, Komisjoni i planeve per Krahine te veje ne disponcjon te cdo shkolle te katundit nga 1—2 metra kubik drrasa, me gjithse qe kerkesat dhe nevojet jane mjaft te mdhaja ne lidhje me objektet e shumta qe ndertohen ne Krahine. Populli mund te kontribuoje mjaft per plotsimin e tyne. Sa per udheheqjen e kurseve analfabetike per femnit shqiptare nder katunde, duhet te bahen perpjekje qe t'afarsohen ne kursin e udheheqsave qe mbahet ne ditlan te ketij mueji, femnit katundare qe dijne pak a shum shkrim e kendim.

Ndertimi i shtepijave kooperative ne rrethin e Pejes

Ne rrethin e Pejes qysh ne fillim t'ukrijimit kane qene parapa 15 shtepi me plan dhe nji jashta planit. Organizatat masovike tue njihere i jane pervesue punes, pregatite dhe perpunue planet operative, studjue mundesit dhe burimet lokale. Katundaret kane fillue pa kurrfare pritese me bajte materjalet e para ne vendet e ndertimit. Keshtu, sot nuk asht ne rendin e dites cashtja e materjalit per murafimin e objekteve. Frontistat me vetedije te plote kane dijte me i cmue bukur mire nevojat e kooperativave dhe kane shprehe deshiren per me i zavendesue sa ma shpejte dyqanet e erta e jo-hygjenike qe kuto te rejat, moderne dhe madheshtore, te cilat do t'i pergjigjen nevojave te ngutshme te tyne jo vetem ekonomike por edhe kulturore. Prandaj cdo moment te lire ndermjet te puneve se fushes kane dijte me e shfrytezue dhe me ia kushtue ngritjes se shtepis. Mbrenda nji kohe shum te shkurte vendet e punimit kane qene mbushe me sjella kub gure, kane sasina te mdhaja gelqere, lande te nevojshme per skele etj. Te gjitha keto pregatitje tashma perfshin mjeshtrine, prisshin ane qe se perbeje grumbujt e mdhaj te materjalit per me ua dhane trajten simbas planit, me i vue themelet e para te ndertimit socjalist n katund. Disa keshilla te Frontit dijten me u-gjete mire perpara kesaj situate dhe me kohe angazhuen nji numer te mjaftueshem mjeshtrish jashta teritorit te tyne, kurse nji pjese tjeter iu pervesuen punes me forcat vehtijane ne ket ndermarrje perparimtare. Fillon germimi i themeleve, me kenge e valle u-vuen guret e pare, me lulet u-vrejshun muret, qe dita dites shtoheshin, dhe me padurim i madhe e i vogel pritshin t'u shohin kulmin e asaj ndertese madheshtore qe do te jete burim kulture e perparimi. Me halle te hupet tenkqesit, cmokiqesit kaurmaloy se me dashamiret e tyne, keshtu sepse e kane krye me kohe premtimin qe ia kane pase dhane Partis dhe shokut Tito, me krenari jane me e ndjuke shembullin e tyne fangret e keshillave te Gorazhdevcit, Pogestes, Papracanit, Dreles, Treboviqit e te Baranit, te cilet kane vendose qe deri me 15 dhjetuer t'a vejne flamurin e te vulvitet ne maje te kulmit. Per keto kooperativa jane sigurue dhe jane me u-transportue dyer e dritaret. Jane marre masat e duhuna per pregatitjen e drrasave. Ka fillue organizimi i ekipave per me pre lande ne pyjet e Rugoves. Dega sindikale e sharrave ne Peje ka marre persiper vullnetarisht e jashte orarit me i pre drrasat e nevojshme per shtepijat e kooperativave. Sasija e landeve per konstrukcjonin e kulmit dhe trenet e ndryshme per te gjitha objektet jane pre e pjesa ma e madhe asht bajte e lutue. Kane fillue pregatitjet per punimet e mbrendshme. Jane ne pregatitje e siper furrat e gelqeres dhe grumbullimi i rames.

Nder disa keshilla sikurse ne Stube Vidanje, Zahaq e Vitomirice puna nuk asht tue u-zhvillue me hovin e dishruem. Perveç arsyenave objektive per keta duhet te shtohet edhe interesimi i kufizuem nga ana e keshillave te ndertimit. Nder keto vende duhet t'i ngjallne edhe ma fort keshillat e Frontit padyshim do te kishin korre sukese ma te dukshme dhe do t'u kishin perballue te gjitha veshtiresinave si transportimit te materjalit nga vendet ma te largta, gjetjes se fuqis puntore te kualifikueme etj.

N. Begolli

Zbatimi i drejte i dispozitave mbi pagimin e puntorve

Ne Fletoren Zyrtare Nr. 41 date 29 V—1948 te RFPJ-s asht botue Dekreti i ri mbi rrogat e puntorve dhe nepunesve ne punet botore. Ky Dekret, sikurse Dekretet e dispozitat tjera mbi pagesat e puntorve, i ka thene ne parimin „gjithkush sipas aftesive — gjithkuji simbas punes", asht edhe nji prove e pushtetit t'one popullor per kujdesin ndaj njerzve punues te Vendit t'one.

Sipermarrja e ndertimeve „Shendog" ne Peje i ka zbatue drejte dhe me kohe dispozitat e Dekretit ne fjale.

Puntoret e kesaj sipermarrje jane klasifikue ne shtate grupe, mbasi per grupe me te nalta (8—9) nuk ka puntore te kualifikuem. Puntoret jane klasifikue drejte se qe s'asht ç'faqe asnji ankim nga ana e tyne

Puna e dobet e inspeksjonit te tregjeve prane Kshillit popullluer te qytetit Peje

Tyshtoqjne te gjitha keshtet objektive per te ushqimin e popullsis se qytetit Peje me poru e perbere te mjaft turshimi, e [illegible] e dhe e dijne te gjithe qytetaret e Pejes, sepse ma te mdhaja te kryne prodhimeve shiten nepet qoshet e rrugeve te qytetit me cmime shum te nalta.

Paraqitet pyetja: a mjafton qe si permarrjet tregtare vetem t'i zbresin cmimet e t'i bajne t'aferta per shtresat e gjana popullore? Natyrisht kjo nuk mjafton, sepse elementat spekulanta formojne tregjet e tyne spekulante.

Me gjithse jane likuidue dyqanet dhe tregtija private, elementat kapitalista perdorin gjithfare menyrash me e vazhdue veprimtarin e tyne spekulante. C'duhet te bajne inspektoriati e tregjeve? Do t'ishte gabim me mendue se keto inspektorina mund t'a kryejne detyren e tyne vetem tue i marre te gjitha masat administrative nga zyra. Ato duhet te jene organe operative te terenit, me vigjilancen e tyne t'i zbulojne dhe ndalojne format e ndryshme te spekulimit, shkeljes s'urdhnave te dhanuna ne lidhje me politiken e cmimeve etj. Keto inspektorija se bashku me aktivistat e mire te Frontit dhe t'organizatave tjera masovike duhet te perpiqen qe te gjitha dispozitat e organeve udheheqse eprore te zbatohen praktikisht. Prandaj, bashkepunimi i ngushte i organeve t'inspektimit te tregut dhe aktivistave te Frontit e t'organizatave tjera masovike asht menyra ma e mire per t'a mbylle deren spekulimit ne tregjet t'ona.

A veprон keshtu inspektorija e tregut ne Peje? Jo! Ju vetem nuk merr kurrfare masash ne ket pikpamje, por lejon me qetsi qe ne qytetin e Pejes te marrin perpjestime te gjana menyrat ma te ndryshme te spekulimit me prodhimet bujqesore. Kushkush nuk mund te besoje se organet e inspektimit te tregut nuk shofin tregje te tana spekuluese nepe rrugt e Pejes (si p. sh. ne shadervan, ke stacjoni i hekurudhes etj), ku shiten e blehen ne sasina te mdhaja gjana ushqimore.

Disa here i asht terhjeke verejtja inspektoris se tregut si nga ana e organeve te kontrollit ashtu edhe nga organet e pushtetit popullor, e gjendja e tregut ende nuk asht permirsue. Edhe disa nepunsa te sipermarrjeve t'ona tregtare mbajne qendrim te dobet ne lidhje me ket qeshtje; — lejojne qe elementat spekulanta te bajne tregti me gjana ushqimore krejt para dyqaneve ku punojne keta vete. Kjo ka ngja ne shum vende te qytetit Peje. Keta nepunsa e shofin kete veprimtari dhe nuk marrin kurrfare masash.

Koha asht me i dhane fund kesaj tregtije spekulative dhe te damshme per interesat e tjerave t'one te punes. Ne trymen e tregjeve t'ona duhet te merren masat ma t'ashpra kundra elementave te ketille. Inspekcjonet e tregut duhet t'a kuptojne rolin e tyne, randesin e detyres se tyne dhe kompetencen qe kane ne lidhje me luften kundra spekulimit ne ditet e sotshme kur i madh e i vogel punon per ndertimin e socjalizmit, ku spekulimi nuk ka vend.

M. Qemali

Antaret e Frontit populluer te keshillit te vendit Hoça Zagradska i kane ndreqe kater rruge katundesh

Keshilli i vendit te Frontit populluer ne Hoçe Zagratska te rrethit te Prizrenit ka marre udhezime nga keshilli i rrethit te Frontit populluer per organizimin „e javes per ndreqjen e rrugeve" qe do te zgjase prej 10 deri me 20 shtatuer. Mirepo, antaret e Frontit te ketij keshilli te vendit kane ndermarre akcjonin e ndreqjes se rrugeve ne rejonin e vet para „javes se rrugeve", ne menyre qe ajo t'i gjeje me rruge te ndrequna dhe te gatshem me kontribue per ndreqjen e rrugeve ne rejonin e ndonji keshilli tjeter. Keshtu me inisjativen e sekretarit te keshillit te vendit te Frontit populluer, Hysen Gashit, dhe aktivistave te tjere me daten 22 gusht te ketij vjeti dulen ne teren ma se 300 antare te Frontit me 60 pende kafshe terheqese dhe ndreqen kater rruge katundesh me nji gjatesi prej dy kilometrash. Per ndreqjen e ketyne rrugeve keta kane bajte ma se 90 metra kub zalle, kane dhane 2400 ore pune krahu dhe 400 ore pune me kafshe. Gjate punes jane zhvillue gara ndermjet antareve te Frontit dhe ne punen e tyne jane dallue Faik Izeti dhe Haki Vella.

Nga BRSS

M. Kalinjin

Bujqesija sovjetike

...Vendi sovjetik nuk asht i mbulluem me copa toke individuale, te copetueme, te rrethueme pa kurrfar sistemi te paraneme nga pronaret privat, por asht i mbulluem me siperfaqe te mdhaja toke t'ekonomis kolektive, me fusha te matuna te ndame simbas nevojes se domosdoshme nga gjeometrat me eksperjence. Me rastin e perpilimit te planit asht marre parasyshe domosdoshmenija pe rradhitjen e tokes, keshtu qe asht aplikue ndrrimi i drejte i fryteve dhe asht çrranjose ekonomija e prones se vogel dhe te mesme.

...Kolhoza asht kooperative bujqesore, komunitet kooperativo-prodhues i katundarve per drejtimin e ekonomis se perbashket. Asht detyre qe, n'interesin e vet katundarve te bashkuem, te drejtohet bujqesija ne menyren ma racjonale. Per kete qellim zgjidhet drejtorija e kolhozit, e cila praktikisht e udheheqe ekonomin e bashkueme.

Kuptohet vetiu se ne drejtorin e kolhozit zgjidhen jo vetem njerez me autoritet politik, por edhe njerez qe kane eksperience n'udheheqjen e bujqesis. Ajo i drejton te gjitha punet ekonomike te kolhozit-bujqesin, blegtorin, organizimin e puneve ekonomike dhe ndamjen e fuqis puntore, si per punet ne fushe ashtu edhe mbrenda organizatave te kolhozit ne ferme, ne hambaret, per mirembajtjen e inventarit mbajtjen e tij ne rregull dhe fioje te tjera te punes.

Drejtorija e kolhozit e lidhe marreveshtjen me stacjonin maqina-traktorist, e gjithashtu edhe marreveshtjet mbi furnizimin e organizatave te ndryshme me prodhimet bujqesore.

* * *

...Punimi kolektiv i tokes asht mekanizue ne pjesen ma te madhe. Numri i traktorve dhe i maqinave te tjera bujqesore sot po rritet ne qinda mija. Asht mjaft me thane se bujqesija e Bashkimit Sovjetik, me pregatitjen e vet teknike, ka dale ne vendin e pare te botes. Prodhimi vjetor mesatar i punes se maqinave t'ona bujqesore, e veçanerisht i traktorve asht mjaft i nalte.

...Kolektivizimi i bujqesis i ka dhane mundesi zgjanimit te siperfaqes se punueme. Kolhozet dhe sovhozet t'ona kane mbjelle komplekse te reja te te hapta, e sidomos asht rritе siperfaqja e mbjellun me bime kulturale bujqesore, te cilat kerkojne perdorimin ma te madh te fuqis puntore, sikurse jane bimet industrijale, barishtet dhe bimet per ushqimin e kafsheve.

...Qe te mundemi me u-çmue rezultatet e ekonomis kolektive, duhet te theksohet se qeverija, paralufte, i ka parashtrue detyre kolhozeve dhe sovhozeve me e arrijte korrjen vjetore prej 8 mijiardave pud (128 miljon tona) dhe se kjo detyre e vjetve te fundit te paraluftes ka qene gadi e zgjidhun.

...Me plot te drejte mundemi me thane se lufta i ka tregue kjarte epersite kolosale te sistemit kolhozjan. „Ne qofte se armata e jone ne vjetin e trete te luftes", tha shoku Stalin, „nuk e duron mungesen e gjanave ushqimore, me qofte se popullsija e jone asht e furnizueme me gjana ushqimore dhe industrijale, e jone me lande te para, kjo gja asht çfaqje e fuqis dhe e aftesis jetesore e ekonomis kolhozjane dhe e patriotizmit te kolhozjanve".

...Kolektivizimi, ndamja e punes ne kolhoze, perdorimi i maqinave bujqesore dhe i metodave shkencore agronomike i gjithe ky proces i gjane e terhjeke me vehte ngritjen e aftesive teknike dhe organizative te kolhozjanve. E pame si tanesi, ekonomija e jone asht nji prej faktorve, ma te randesishem te fuqis ekonomike te Bashkimit Sovjetik.

(Nga artikulli i Mihajl Kalinjinit „Fuqija e shtetit Sovjetik".)

Ne Prishtine hapet shkolla ne gjuhen shqipe per mami

Krahas me zhvillimin e kuadrave te reja per plotesimin e detyrve te parapame ne Planin pesvjeçar te Krahines se Kosmetit, tue pase parasyshe ngritjen dhe aftesimin e kuadrave shendetsore, sidomos te shqiptare, Kryesija e Keshillit Krahinuer te Kryqit te Kuq ne Prishtine, ne vitin shkolluer 1948-49, hape ne Prishtine shkollen e mamive ne gjuhen shqipe, me qellim qe edhe te rejat shqiptare t'aftesohen ne plotsimin e detyrave shendetsore, qe ma perpara nuk kane pase mundesi.

Te rejat shqiptare qe dijne me kendue dhe shkrue do te pranohen ne shkollen e mamive pa ndonji pengese dhe Fronti i grues Antifashiste duhet te jete i pari per gjetjen dhe regjistrimin e naxeneve, te cilat me mbarimin e kesaj shkolle aftesohen per sherbimin sanitar tue i dhane fund te gjitha bestytnive qe ende diku-diku e zavendesojne shkencen medicinale.

Per ket qellim ne Prishtine hapet kjo shkolle ne gjuhen shqipe, qe asht shkolle e pare ne historin e popullit t'one. Me anen e kesaj te rejat t'ona do te mesohen me ju pergjegje detyrave te shejta n'edukimin e brezave te reja, n'aftesimin e kuadrave te reja shendetsore.

R. Jusufi.

Shpejt do te hapen ne Krahinen t'one 2 shkolla medicinale t'ulta

Kryesija e Keshillit te Kryqit te Kuq hap shkollen e ulte medicinale ne Peje ne gjuhen serbishte dhe ne Prizren ne gjuhen shqipe.

Ne keto shkolla pranohen te rijt dhe te rejat qe kane kryе shkollen fillore. Keshillat e vendeve, ne bashkepunim me organizaten e Rinis, duhet t'u vijne ne ndihme shkollave qe te regjistrohen naxenesit, te cilet e kane kryе shkollen filloге e qe nuk kane vazhdue, por merren me pune bujqesore.

Secili kandidat qe i pergjigjet kondítave duhet te regjistrohet pa-vonese, mbassi kjo asht n'interesin e tij e n'interes te popullit.

Per pranimin ne shkolle duhet te paraqiten keto dokumenta:

1. Diftesa mbi mbarimin e shkolles fillore.
2. Certifikata mjekesore,
3. Çertifikata e dat-lindjes. Kandidati-ja duhet te jete jo ma i ri se 15 vjeçe e jo ma i vjeter se 25 vjeç dhe
4. Çertifikata e mire-sjelljes.

Tue e çmue randesin e ketyne shkollave, me ane t'organizatave te ndryshme duhet qe numri i parapame per keto shkolla te plotsohet, ne menyre qe me 20 shtatuer te k. v., te filloje mesimi i rregullt, sikurse ne shkollat e tjera te mesme dhe profesjonale.

Arsim e Kulture

Theatri populluer i Krahines s'one filloi pregatitjen e çfaqjeve theatrale

Me 1 shtatuer te ketij vjetit afer 20 artista theatrale, serbe e shqiptare, kulluetare me punne atje ku asht ne voja ma e madhe per pune, ku populli asht ma i etshem per kulture e art, u paraqiten ne krye te detyres dhe filluen punen.

Grupi i theatrit serb filloi pregatitjen e repertoarit dramatik. Ne repertoar jane parapa 12 drama t'onat dhe sovjetike. Ne muejin tetuer fillon pregatitjen e çfaqjeve edhe grupi theatral shqiptar i theatrit populluer.

Keto dite ka fillue gjetja e inventarit theatral. Deri tash jane gjete disa kostume popullore. Ne numrin e kaluem te fletores s'one Drejtorija e Theatros ka bote nji shpallje ne lidhje me gjetjen e kostumeve popullore, armve te vjetra etj. Asht ne formim e siper edhe grupi teknik i theatrоs.

Çeshtja e sigurimit te kuadrave shqiptare shkon me veshtiresina. Veç pengesave tjera, disa prinde, per hir te lokalizmes patrijarkale te rranjosun ne shpirtin e tyne, nuk i lejojne femijt e tyne talenta per t'u paraqite ne Theatro. Me kei veper ata e pengojne si perparimin e femijve te tyne talenta, ashtu edhe perparimin e popullit shqiptar pergjithesisht.

Si problem paraqitet edhe mungesa e veprave dramatike ne gjuhen shqipe. Perveç masave qe do te marre Drejtorija e Theatrit me ane te shpalljes se konkurseve per shkrime dhe perkthime dramash, asht e mira qe çdo shqiptar i cili mund te kete ndonji veper dramatike, t'a veje ne dispozicjon te Theatrit.

T'a ndihmoje Theatrin t'one qe asht nji nder armet ma te forta per ngritjen e kultures, artit dhe edukimit socjaliste te masave t'ona popullore.

Ne kursin grafik sigurohen kuadra te reja shqiptare e serbe per shtypshkronjat t'ona

Ne Prishtine, para dy javesh u-hap kursi grafik prane shtypshkronjes "Progres", ne te cilen marrin pjese 28 te rij e te reja shqiptare-ne shumice e ma pak serb. Kursi udhehiqet prej Kovaçeviq Bozhidar dhe Janzhenkoviq Mirko-qe te dy nga Novi Sadi.

Prej kursistave, ma se shumti ka dergue Mitrovica, Prizreni, Peja e mandej Prishtina, Ferizaj, Gilani e Vuçiterna. Asht per t'u-çuditе se si rrethi i Gjakoves s'ka dergue asnji kursist, kurse prej andej duhesh te vijshin ma se shumti. Si duket, ne Gjakove s'asht ba agjitacjoni i duhun ashtu si nder vendet tjera nga organizata e Rinis, Frontit populluer, sindikata me gjithe qe shpalljet e hapjes se kursit jane dergue me kohe.

Nder kursistat pese jane femna-tri shqiptare dhe dy serbe. Prej gjith ketyne kursistave, 14 mesojne ne degen e rradhitsave, 6 n'ate te maqinave, 6 si liber-lidhsa dhe 2 si leter-shtyesa.

Nder te gjithe keta, te bie ne sy Zef Tupeci, nga Prizreni. Me gjithe qe ay i ka 16 vjeçe, asht i vogel dhe shum i gjalle ne pune.

—Mue me pelqen shum kjo zeje dhe s'me duket aspak e veshtire-thote Zefi.

E, me te vertete, po t'i shiqojsh kursistat, mbas 7 dite mesimi theorik e tri dite praktike, te japin bindje se kane mesue mjaft mire. Ne degen e rrradhitsave dikush i radhite germat tue krijue fjale dhe rreshta, dikush tjeter i çrradhite. Ata i kane mesue deri diku bukur mire edhe emnat e llojeve te germave, qe jane mjaft te veshtire.

Ke maqina e madhe e shtypit bajne mesim theorik e praktik disa shqiptare nga Vuçiterna, Prishtina, Gadi qe te gjithe i pergjigjen mjaft mire pyetjeve t'udheheqesit te kursit. Njeni e bon proven praktike se si duhen rradhite 16 faqe te nji broshure kur ato vehen ne shtratin e maqines-te gatshme per shtyp. Problemi asht mjaft i veshtire sepse duhet pase parasyshe qe me mbarim kur te vije koha e lidhjes se broshures, te vijne faqet njena mbas tjetres. Per ket u-pergjegj ma se miri kursisti Abdurrahman Ibrahimi, ndersa per ate me 8 faqe Ashim Hajrizi.

Tashma, asht tue u-njofte prej shoqesh te reja edhe lidhja e librave dhe shtyemja e letrave.

Kursi do te zgjase 6 muej dhe shpresohet qe te gjithe kane me e perfundue ket me sukses. Qe te gjithe i duen mjaft mesimdhanesit e tyne dhe i respektojne ata ashtu si duhet.

Qe te gjithe, me perjashtim t'atyne nga Prishtina, jetojne n'internat, pjesen ma te madhe te shpenzimeve te tyne e paguen sipermarrja "Progres", e diferenca tjeter paguhet nga rroga e tyne mujore.

Ne perfundimin e kursit, ata qe do t'a kalojne ate, do te punojne prane dy shtypshkronjave t'ona Krahinore ne Prishtine, tue i gezue te gjitha te drejtat si puntoret tjere n'ekonomin e Vendit t'one.

Ma shum kujdes per plotsimin e fuqis puntore ne sipermarrjen per ndertimin e hekurudhes Metohi—Prizren

Sipermarrja numer 3 per ndertimin e hekurudhave e cila ka punue deri tash per ndertimin e hekurudhes Prishtine—Kurshumli, asht transferue me qender ne Peje dhe punon per ndertimin e hekurudhes Metohi—Prizren.

Ne pjesen e pare dhe te dyte te hekurudhes asht tue u-zhvillue nji pune e hovshme per rregullimin e terrenit. Mirepo, sipermarrja do te mundet me korre rezultate edhe ma te mira sikur t'ishte komplitue me fuqi te mjaftueshme puntore gja qe nuk ka ngja ne periudhen 17—30 gusht te k. v. Prej 1500 puntoresh qe asht dashte t'i siguroje rrethi i Prizrenit, deri me daten 28 te k.m. nuk e ka dergue asnji; rrethi i Rahovecit ka pase me sigurue 1000 e ka dergue 71 puntore; rrethi i Pejes prej 500 puntorve ka dergue 243; i Istokut prej 500 puntorve ka dergue 255 vete e ai i Gjakoves prej 500 puntorve ka dergue 150 vete. N'anen tjeter keshilli populluer i qytetit te Pejes nuk i ka dhane kurrfare ndihme drejtoris se sipermarrjes per vendosjen e personelit dhe t'ingjinjeravе te cilet jane tue vuejte mjaft per mungese banesash.

Tue pase parasyshe randesin e kesaj hekurudhe asht e domosdoshme qe te bahet nji lufte e rrepte per sigurimin e fuqis puntore, e sidomos nga ato rrethe qe u permenden, ne menyre qe sipermarrja te mundet me ba nji pune edhe ma intenzive per kryemjen e kesaj hekurudhe; e keshilli populluer i qytetit te Pejes te kujdeset ma teper rreth vendosjes se personelit te sipermarrjes.

Fiskultura dhe Sporti

Ndeshje miqsore footballi

„Proleteri" (Prishtine) „Dinamo" (Shkup) 5:1 (3:1) Te vetmin gol Dinamo e shenon nga opsajdi

Te djelen me 29 gusht, u-zhvillue ndeshja miqsore ne mes te skuadres se Sh. S. „Proleter" te Prishtines dhe asaj te Sh. S. „Dinamo", kampjone e Makedonis dhe antare e liges se Dyte te Jugosllavis, e cila perfundoi me fitimin e madh te Proleterit: 5—1 (3—1).

Qysh me fillim te lojes Dinamo sulmon ne porten e Proleterit dhe centri merr nji top nga liege dhe pergatitet me gjuejte, por arbitri fryn opsajd. Dinamo sulmon perseri dy tri here me rradhe por mprojtja e Proleterit ka vendosun mos me lejue me u-muejte, i perballon me giak ftohtesi sulmet e kundershtarit dhe e furnizon me topa vijen e pare e cila, mbas kater minutash, kalon ne sulme te njimbasnjishme dhe ne minuten e gjashte, Ashimi ia kalon nji top te gjate Gjinalit, ky e tripllon centerhallfin e Dinamos dhe ia kalon topin centrit Ambroz. Ky pa e ndalue ia kalon Gjorgjeviqit i cili e shenon golin e pare me nji shut te forte ne qoshen e majte te portes se Dinamos.

Loja bahet edhe ma e gjalle, ma e bukur, ma e kombinueme nga te dyja anet dhe topi shkon me kalime te bukura here ne njenen here ne tetjeren ane te fushes. Ne minuten 23, Sehabudini ia kalon topin Redutit, ky centron bukur ne mjedis te fushes ku ndodhen Gjinali, Ambrozi e Gjorgjeviqi, topin e merr ky i fundit dhe, me nji shut teper te forte, u godit shtyllen e djathte te portes se Dinamos dhe topi prej shtylles shkon si plumb ne qoshen e majte ne rrjete. Goli i dyte i dha zemer edhe ma teper skuadres vendase e cila sulmon pa pre ne porten e musafirve, dhe mbas dy minutash, d. m. th. ne minuten 25 beqa i majte i Dinamos tue dashte me shkatrrue sulmin e vijes se pare te Proleterit, perpiqet me e largue topin me kombe por e çon ne rrjeten e vet. Ky autogol e hypi rezultatin 3—0 per Proleter.

Publiku i Prishtines i etshem per nji loje te bukur si kjo e sotshmja, e pershendete lojen e te dyja paleve e sidomos te skuadres se vet, e cila me vijen e pare: Vaça, Gjorgjeviq, Ambrozi, Gjinali e Isa, din me i çrytue te gjitha rastet e volitshme ne porten e kundershtarit.

Por edhe skuadra e Dinamos e merr veten, zbret shpesh me kombinime te bukura deri ne zonen e bekave te Proleterit, por edhe mprojtja e Proleterit me Osmanzhikun ne krye din fort bukur jo vetem me i prapsue sulmet e kundershtarit por edhe me furnizue me topa vijen e pare. Ne minuten 31 Dinamo shenon golin e pare me anen e centrit i cili bashke me mesallen, kane qene opsajd por arbitri tue prite shenjin e vije-rojes, nuk fryn e Dinamo perfiton me shenue gol. Koha tjeter deri ne fund te lojes se pare kalon me kombinime te te dyja paleve pa rezultat.

Ne lojen e dyte Skuadra e Dinamos hyn ne fushe me formacjon te ndryshuem, kurse Proleteri po me ate formacjon. Dinamo duket se e ka vendose me bashkue ose te pakten me e paksue rezultatin. Qysh ne fillim zbret disa here me rradhe ne zonen e Proleterit, gjuen shpesh ne porte por Reshaku, portjeri i ri dhe mjaft energjik i Proleterit, mpron bukur. Ne minuten e 10, Gjinali e udheheqe vetem topin deri ne zonen e bekave te Dinamos, ia kalon topin Gjorgjeviqit, ky ia lshon Vaçes i cili shuton fort, portjeri shtrihet por topi i rrshqet nga duert dhe Ambrozi i cili ne ndeshkohe kishte mberrijte shum afer portes e shenon golin e katert per Proleterin. Golin e peste Proleteri e shenon ne minuten 15 te lojes se dyte me anen e Ashimit ne gjuejtjen e fallit prej 30 metra larg portes. Mbas ketij goli, Dinamo i shtrengon rradhet e veta, sulmon pa pre ne porten e Proleterit, por nuk din me i çrytue rastet. Loja vazhdon e bukur, e shpejte pa incidente e loje fer aslipet deri ne minuten 37 te lojes se dyte, kur referi e ndalon, me marreveshtjen e te dyja skuadrave, per shkak t'errsires qe u shkaktue nga koha e vranet e me shi.

Me formacjonin: Surroi, Ashim, Osmanzhiku, Sehabudini, Dymitrijeviq, Shantiq, Vaça, Gjorgjeviq, Ambrozi, Gjinali e Isa me nji ndryshim ne linjen e hallfeve, Skuadra e Sh. S. Proleter jep me shpresue shum ne lamen e lopit me kambe.

Lojen e arbitroi mire Voja Tomiqeviq.

H. Tufa

Nga situata nderkombtare

Lufta e klases puntore te Japonis kunder planeve robnuese t'imperjalistave amerikan

Imperjalistat amerikan dhe japonez, sidomos ne kohen e fundit, bajne fushate te terbueme me fuqi e bashkuene kunder klases puntore te Japonis. S'kane kalue ma shum se dy jave prej dites, kur bota e ka marre vesht me indinjate perpjekjen e poshter te komplotistave amerikan qe t'i shuejne jeten e luftarit te pare te puntorve, sekretarit te pergjithshem te Partis Komuniste te Japonis — Tokudes, e qeverija japoneze e ka ba nji shkelje brutale ne te drejtat e klases puntore. Ne perleshen e komandantit madh te fuqive okupuese t'Amerikes ne Japoni — Mark Arturit, qeverija reaksjonare e Ashidit, ne fillim e ketij muaji, nen kercnimin me burg dhe me gjobe me te holla, ka ndaluar, çdo greve ne mbare vendin. Ajo gjithashtu u ka marre te drejtat puntorve per lidhjen e kontratave kolektive. Ne mbare vendin, organet e policis amerikan dhe policija japoneze bajne potere t'ashper ne puntore, i burgosin udheheqsit e sindikatave dhe te komunistave, i ndjekin organizatat demokratike e sidomos Partin Komuniste te Japonis, e cila asht fotre ne te t'eksploatatorve Amerikano-Japonez. Tue e rritur sulmin e vet ne masen ma te gjane te Japonis, partnerat imperjalista e pregatisin revizjonin e ligjeve qe shkaktuen [illegible] dhe publik, ushtria nga sherbimi te nepunsave shteteror dhe nji rresht masash te tjera antipopullore. Ne shtypjen e pafajshem kunder puntorve te Japonis, ata tregojne se nuk kane pa perdore edhe metoda thjeshte fashiste ne luften kunder popullit e bile edhe vrasja te nepunsave qytetare.

Por, sulmet e reaksjonit te bashkuem nuk i kane detyrue puntoret per t'i ndigjue. Perkundrazi, ato kane ba qe te perforcohen edhe ma teper pradhet e klases puntore dhe kane shkaktue nji valle te re te grevave dhe te protestimeve ne gjithe Japonin. Ne keto dite kompanija ma e madhe japoneze e vaj-gurit "Tejkoku petroleum kompani", per shkak te greves puntore, e ka ndalue plotsisht produktivitetin. Ne kryengritje kane marre pjese edhe puntoret e bekurdhave shtetnore n'Ishullin Okaido. Lufta e ka perfshi edhe bashkimin e pergjithshem japonez te puntorve te komunikacjonit bashkimin e puntorve te bekurdhave shtetnore, organizatat e ndryshme te puntorve industriale, sindikatat e puntorve elektro-industrial, dhe sindikatat e bashkimet tjera. Luften ne [illegible] [illegible] [illegible] [illegible] qeverise dhe sipermarrjeve komunale, prefektura qe sigurojne kundersht [illegible] te ligjit mbi sherbimin shteteror e [illegible] dhe [illegible] te [illegible] nepunsave.

Kur ndalimi formal i grevave ka [illegible] [illegible], qeverija e ka forcue bashkimin terroristike kunder grevistave. Nga shume qytete te Japonis merren lajme mbi perpjekjet e perjashtimeve ne masa te grevistave dhe te polisis. Ne kete menyre, kunder puntorve dhe nepunsave t'industris japoneze te fuqishme te [illegible] e qytetit Tokjo, te cilet kane marre pjese ne greve, Mak Arturi dhe qeverija japoneze i kane dergue 1200 polic t'armatosun dhe kater tanksa amerikane.

Tentimi per te krye atentatin mbi Tokuden, ndalimi i grevave dhe terrori ndaj turmave popullore, te gjitha keto masa deshmojne mbi dobesin e imperjalistave amerikan dhe te marionetave te tyne japoneze. Nga ana tjeter, keto masa kriminale dhe tendencat e vendimeve e turmave ma te gjana popullore ne te cilat kane ndeshe, deshmojne mbi perforcimin e vazhdueshem te fuqive anti-imperjaliste ne Japoni dhe te kushteve te nji politike te popujve japonez, te cilet bajne luften vendimtare, nen udheheqjen e Partis Komuniste te Japonis, per pavaresin kombtare dhe ekonomike te Japonis dhe per nji jete ma te mire te njerzve puntore te Japonis.

Populli i Malajes e vazhdon me sukses luften per çlirim

Lufta Çlirimtare e popullit te Malajes po ndizet gjithnji e ma teper. Me gjithse lajmet e pakta mbi zhvillimin e operacjoneve ushtarake te fuqive kryengritese dhe grushtet qe ata u apin imperjalistave britanik keta gjithnji e ma teper po duken sheshazi. Britanija e Madhe asht detyrue qe gjithnji te dergoje atje fuqi te reja. Ne kete menyre, tash s'afermi nga Britanija asht dergue brigada e dyte e qytetit te Londres, mandej njisija per lidhje, njisit sanitore, inxhinjere dhe njisit e tjera ndihmese. Gjithashtu asht dergue edhe nji regjiment kursoresh me nji njisi te tanksave te lehta. „Dejli vorker" i Londres shkruen se tash ne luften kundra kryengritsave gjinden ma teper se 50.000 ushtare britanik dhe se kryengritja e ka perfshi pjesen ma te madhe te Malajes.

Fuqit perparimtare ne bote u apin perkrahje aktive luftarve per çlirimin e Malajes. Lufta e tyne gjen mbeshtetje bile edhe ne Britanin e Madhe. Partija Komuniste e Britanis se Madhe i ka drejtue ne keto dite nji proklamate levizjes puntore britanike, me te cilen e thrret qe te protestoje kunder luftes ne Malaje dhe te kerkoje qe me njihere te ndalet lufta barbare kolonjale.

Ne proklamate tregohen metodat barbare, qe imperjalistat britanik i zbatojne ne luften e vet, kunder malajasve. Bombardimi i katundeve, vrasja e njerzve te pa-armatosun, e grave dhe e femijve, shkatrrimi i organizatave demokratike dhe sindikale, perfitimi i gjurmesave te njohun ne kremin te njerzve, t'ashtuquejtun „Dijak", te gjitha keto jane mjete, me te cilat imperjalistat mendojne se do te mundojne me e shue levizjen çlirimtare te popullit, qe lufton per pamvarsi.

Partija Komuniste e Britanis se Madhe e thrret puntorin te kryej presjon ne qeverin laburiste me qellim qe te ndalen mnjasimet te cilat e veshtirsojne edhe ma teper gjendjen e vshtire te turmave puntore britanike. Ajo tehkson se kjo i sjell dobi vetem nji grupi te vogel te monopoleve britanike te kauçukut te cilat nuk duen me hjeke dore nga eksploatimi i territoreve dhe i popujve te huej. Popullit puntor kjo lufte i sjell vetem veshtiresi dhe privime te reja.

Lufta çlirimtare e popullit te Malajes perfaqson pjesen e luftes se madhe çlirimtare te te gjithe popujve azjatik. Siperthani i kesaj lufte edhe nji here tregon se nuk ka dan fuqije qe mundet me e ruejte rendin imperjalist ne kete pjese te botes. Luftaret e Malajes e dijne se nuk jane vetem. Me'ta asht levizja çlirimtare e tane popujve azjatik, me ta jane fuqit perparimtare te mbare botes e edhe fuqit perparimtare te Britanis se Madhe.

Ndertimi i krahinave te shkaktrrueme gjate luftes ne BRSS

Sot ma ne pjesen e dyte te vjetit te trete te Pjatiletkes se mbas-luftes, ne Bashkimin Sovjetik jane mberrijte rezultate te medhaja ne ndertimin e krahinave te shkatrrueme nga okupatori.

Kujdes i veçant i asht kushtue ndertimit te ndertesave te banimit dhe te kolhozeve. N'Ukraine ma teper se dy miljon e 600 mije jane fute ne shtepijat e ndertueme rishtas. Mbas çlirimit asht çfaqe nevoja per ngritjen e katundeve te tana, si edhe rindertimi me themel i objekteve kolhoziane. Qeverija Sovjetike i ka dhane te gjitha mjetet e nevojshme per shpejtesimin e rindertimit. Perveç tanjes, ne disponicjon te materjalit kolaual per ndertime dhe materjalit tjeter, kolhozjanet kane marre kredite te cilat shprehen me qinda mija rubla.

Perveç rindertimit t'Ukraines, edhe ne R.S.S. te Belorusis jane ndertue afer 340.000 shtepija. Jane rindertue plotsisht ma teper se 2000 katunde dhe lokalitete.

Ne mbare Ukrainen asht rindertue rrjeta e parashtes e institutave bujqesore shkencoro-hetuese. Ne republike punojne 9 institute, 26 stacjone shkencoro-hetuese, e perveç kesaj rregjistrojne edhe 40 pròna shembullore. Instituti i Dnjepropetrovskit per kulturen e perimeve punon me shuma sukses, i cili i furnizon me fare te klasit te pare kolhozet per prodhimin e farave ne krahinat jugore t'Ukraines.

Ne krahinat e Leningradit kane lindë gjithashtu me qinda katunde te reja dhe jane ndertue ekonomi kolhozjane. Jane lane katundet e vogla, ne te cilat kane jetue kolhozjanet. Katundet e reja jane ngrite me plan dhe apin mundesi te plote per zhvillimin e jetes ekonomike dhe kulturale. Sa vepra jane ba ne rindertimin shifet nga shembulli i katundit Krasno-sello ne krahinat e Leningradit. Kete katund çlirimi e ka gjete te shkatrruem plotsisht e ne 'te atehere kane qene vetem 9 banore. Katundi tash ka 250 shtepi dhe disa mije banore. Ne kete krahine te shkatrrueme nga lufta jane rindertue 33 mije ndertesa kolhozesh dhe 20.000 per banim. Gjithashtu jane elektrizue afer 200 kolhoze.

Qytetet e medha, qe jane shkatrrue ne kohen e luftes, jane rindertue perseri. Ne to kane fillue punen sipermarrjet industriale dhe institutet e tjera. Ne Harkov jane rindertue ma teper se 700 sipermarrje. Keto sipermarrje i furnizojne kolhozet me maqinat dhe veglat e nevojshme dhe i apin vendit prodhime te tjera te nevojshme per rindertimin e plote te krahinave te shkatrrueme.

Lajme te shkurta

Situata ne France

PARIZ:

Agjensija "Frans Press" njofton se kryetari i Rrepublikes Franceze Vensan Oriol, i besoi mandatin per formimin e qeveris se re socjalistit Paul Ramadier-it, ish kryetarit te qeveris ne vjetin 1947.

Metingje dhe greva neper sipermarrje

PARIZ:

"Tanjug" lajmeron: dhanja e dorehegjes se Mario-s u-ba shkak i plasjes se grevave ne shum sipermarrje te mbare vendit. Ne kete rast puntoret berkuen zgjidhjen demokratike te kesaj krize te qeveris. Perveç kesaj jane gjithnji tue mberrijte telegrame nga sindikatet dhe organizatat tjera masovike te mbare vendit, me ane te cilve kerkojne formimin e nji qeverie te bashkimit demokratik.

Armata Demokratike e popullit grek po ban luftime te rrepta

ATHINE:

Radio-stacjoni i Greqis se lire transmeton komunikatan e Shtabit Madhuer t'Armates Demokratike mbi operacjonet ne Greqi, ku, perveç tjerash, thuhet: "Ne zonen e Rumelis, njisit e Armates Demokratike kane sulmue dhe pushtue katundet: Velice, Pteler, Vromopilago, Ksirovuni dhe Hanilola. Ne fushe te luftes, anmiku ka lane 36 te vdekun dhe 33 te plagosun. Asht zane nji sasi e madhe materiali luftarak. N'Epir, ne rrethin e Elatos, njisit e Armates Demokratike e kane shpartallue te 623-in batalion monarko-fashist.

Njisit e Armates Demokratike ne luftimet e bame ne Maqedonin Qendrore prej 24 deri me 27 te gushtit, nxuerren prej luftimit 64 ushtare monarkofashista. U hodhen n'ajr nji ure hekuri dhe dy tjera druni. Ne rradhet e Armates Demokratike kane hye 40 luftare.

Notat e qeveris bullgare drejtue qeveris Turke

SOFJE:

Korespondenti i „Tanjugut" lajmon: Qeverija bullgare i ka dergue Qeveris Turke nji note me ane te se cilës protestoi kundra vendimit, qe ka marre gjyqi i Istambullit mos me dorzue organeve te pushtetit bullgar kriminelin Mihallkov dhe antaret e tjere te bandes, te cilet kane vra dy pilota bullgare n'avjonin qe mban vijen ajrore Burgas — Sofje. Ne ket note thuhet se ky akt i gjyqit Turk cenon te drejten nderkombtare dhe konvencjonin mbi dorzimin e kriminelave, i cili konvencjon asht nenshkrue ndermjet Bullgaris dhe Turqis.

Qeverija Bullgare i dergoi edhe nji note tjeter me ane te se cilës protestoi kundra sjelljes se patjeshme kundrejt ushtarve bullgare, te cilet kane çfaqe deshiren me u kthye ne Bullgari.

Reakcjoni don me formue administrate separatiste ne qytetin e Berlinit

BERLIN:

Korespondenti i „Tanjugut" lajmon: Fletorja „Neues Deutschland" meson se shumica reakcjonare (socjal — demokratet, liberalet dhe demokratet kristjan) te kuvendit te qytetit te Berlinit nen patronatin e organeve okupuese britanike, ka vendos me u-mbledhe ne ndertesen e vjeter te Reichstag-ut ne sektorin britanik te qytetit. Ne ket mbledhje do te vendoset mbi formimin e administrimit separatist per sektoret perendimore te qytetit te Berlinit, gja qe do t'a ndante qytetin defenitivisht ne dy pjese.

De Gasperi nuk don me dijte per kerkesat e puntorve

ROME:

Kerkesen e konfederates, e cila kerkon mbledhjen e parlamentit per me shqyrtue gjendjen e krijueme me burgosjen e disa udheheqsave te sindikatit, Kryetari i Qeveris Italjane De Gasperi i pergjigjet se nuk do t'a marre parasysh kerkesen e permendun te konfederates dhe se parlamenti nuk do te baje mbledhjen e caktueme.

Botimi i Keshillit Krahinuer te Frontit populluer—Sipermarrja per shtyp dhe botime "Miltadin Popoviq" Prishtine.
Pajtimet ne fletoren i pranon: Administrata dhe ekspedicioni. Numri i çekut 906838.